



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 23

Datë: 02. 03. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Raporti nga QNR

3. Aktivitetet e ZRPP-së

Raportim për afatin e dorëzimit të Raporteve Vjetore Financiare për 2020

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në: Deçan, Shtime dhe Novobërdë:

4. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve. E hapi mbledhjen e 23-të të KQZ-ës, më rendin e ditës si në propozim. A ka dikush vërejtje?

Sami Kurteshi: Ky rend i ditës është në rregull, mirëpo ka edhe pika të tjera që unë propozoj që të futen këtu edhe qofshin në kuadër të pikës së dytë apo në një pikë të veçantë, kërkoj që të na ofrohen raporte, raporti i votimit me kusht sepse aty ka përfunduar numërimi, të na ofrohet raporti i procedurës së klasifikimi, verifikimi e votave më post sepse ka filluar votimi me post, dhe të na ofrohet një raport i të gjitha dërgesave që janë pranuar nga posta pas datës 12 shkurt në KQZ dhe mandej të diskutohet për ato çështje, sepse kemi çështje për të cilat duhet që të i diskutojmë.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Raporti nga QNR

Burim Ahmetaj: Sot paradite kam dërguar raportin, praktikisht rezultatet e votimit më kusht proces i cili ka përfunduar me datën 1 mars 2021, ndërsa në raportin e QNR-ës janë edhe 2 raporte tjetër: pra raporti i periudhës së votimit përmes postes ky është i specifikuar në detaje secili proces dhe totali i votave të vlefshme nga periudha e Shërbimit Votues pra votimit përmes postes, është edhe një raport i bashkangjitur për pranimin e pakove përmes postave që pranimi është bërë pas datës 12 ditore, të gjitha raportet janë në kuadër të aktiviteteve të sekretariatit dhe sigurisht që sekretariati do të i prezantoj.

Valdete Daka: Kush është për këtë rend dite?

Alim Rama: Faleminderit Burim për këto raporte, por për këto çështje KQZ-ja duhet të merr vendim, KQZ-ja mundet të vendos a me i pranuar ato a jo, ato që kanë ardhur pas datës 12. Po ashtu ne kemi pranuar raportin më email të zarfeve të votave më kusht se si janë trajtuar por nuk është si pikë e veçantë, duhet të marrim një vendim të konfirmimit në qoftë se dikush ankohet për një proces apo tjetër duhet për të pasur një bazë ligjore, kështu që kemi edhe raportin e votimit jashtë Kosovës, është raporti përmbledhës këtu por nuk ka ndonjë rekomandim. Këtu i kemi çështjet që nuk është vetëm thjesht njoftim, po e shohim

se diku 22.000 vota përafërsisht janë larguar ose janë refuzuar duhet KQZ-ja që ta marrim një vendim për këto.

Sami Hamiti: Tani po flasim për një proces që kemi pasur një vendimmarrje, është një vendimmarrje edhe për votat të cilat që kanë ardhur përmes postes dhe diasporës kemi vendosur kriteret të cilat sekretariati vetëm i ka zbatuar, dhe konsideroj që tani asnjë nevojë për vendimmarrje tjetër kur ne e kemi marr një vendim edhe procedurat edhe rregullat janë vendosur këtu në KQZ, edhe një plan operacional në të cilin dihet edhe data e saktë se deri kur arrin. KQZ-ja nuk mundet të vendos hiq jashtë ligjshëm sepse ekziston një vendim i kushtetueses në të cilin përcaktohet data deri kur ato zarfe do të trajtohen. Unë shoh së brenda për brenda aktiviteteve të sekretariatit janë këto raportet të tilla në bazë të vendimeve dhe klasifikimet që i kemi bërë në planin operacional dhe vendimet që i kemi marr, dhe kriteret që i kemi vendosur për votimin jashtë vendit të cilat kanë qenë të gjitha në ueb-faqe, proceduralisht nëse ne kemi diçka ose ka dikush vërejtje nga ne, nga anëtarët, apo nga subjektet politike nesër do të përfundoj ky proces deri në fund, shpallen rezultatet dhe ka të drejtën e ankimit në PZAP. Nuk mundemi ne të marrim votimet e dyfishta apo të trefishta për një proces që e kemi marr një vendim dhe i kemi vendosur ato kritere. Prandaj kisha sugjeruar unë znj. Kryetare të vazhdojmë më rendin e ditës që e kemi dhe brenda pikës atëherë të i trajtojmë këto raporte që janë.

Eshref Vishi: Jo çdo raport duhet të ketë rekomandime, në rastet kur administrata gjatë procesit zgjedhor e sheh që një çështje duhet të ketë vendimmarrje atëherë e rekomandon vendimmarrjen, çdo raport nuk duhet të ketë edhe vendime për vendimmarrje dhe kështu që administrata është e gjitha në rregull dhe mund të vazhdojmë me rendin e ditës.

Valdete Daka: Faleminderit Eshref, po urdhëroni Sami.

Sami Kurteshi: Sa i përket këtyre raporteve, ne duhet të i kemi raportet dhe raportet janë nëse KQZ-ja i pranon si rekomandime sepse raporti është këtu, atëherë unë mendoj se në çdo rast të gjithë qytetarët, votuesit, subjekte duhet që ta kenë të hapur rrugën e shterimit të mjeteve juridike kjo është në rregull. Sa i përket çështjes së raportit që e kemi marr për klasifikimin e votave nga mërgata, unë e kam shikuar më shumë kujdes, kam bërë përpjekje më pa ligjin dhe rregulloret dhe unë po them se këtu është një klasifikim i cili nuk mundet të gjendet në asnjërin nga dokumentet nga ligjet në fuqi apo nga dokumentet aktet nënligjore të miratuar nga vetë KQZ-ja për këtë klasifikim që është bërë këtu, e kemi klasifikimin

D1,D2,D4,D5,D6, atëherë unë po e them një çështje sepse përveç një verifikimi që është bërë dhe janë vërejtur nga vetë sekretariati, nga vetë aplikimi ose procedurat e aplikimit se janë bërë lëshime teknike të mëdha gjatë regjistrimit, aplikimit ,konfirmimit që ne i kemi përmend vetëm si raste individuale që na kanë ardhur neper mesazhe dhe mendojë që janë me qindra apo mija të tilla, këtë mundën të e konfirmojnë nga sekretariati. Ne i kemi p.sh kategori të tilla që unë po dua që të i përmendi, thotë votuesit që kanë dërguar dy here fletëvotime, çfarë është kjo si është bërë klasifikimi. A është hequr neni apo neni është len? Apo do të dërgohen në prokurori këto vota të dyfishta apo çfarë do të ngjan. Çështja tjetër është votuesit të pa identifikueshëm votimi grupor, ne nuk kemi ndonjë definicion të kësaj çështje kjo është futur këtu dhe nuk e di ku është marr, mirëpo në çdo rast ajo që kam dëgjuar unë nga sekretariati dhe QNR është kjo: nëse në një zarf qenkan 7,8,9 po e marrim 10 fletëvotime që nuk mohohen që janë të një familjes sepse janë më një mbiemër, mirëpo nga 10 fletëvotimet njeri prej tyre nuk e ka dërguar një dokument identifikimi për arsye të ndryshme që as unë nuk i di, e as këta me gjasë nuk i dinë mirëpo nga ajo që kam dëgjuar që tani mund ta vërtetojmë thonë se i gjithë zarfi anulohet sepse njeri nuk e ka dërguar një dokument identifikimi.

Arianit Elshani: Ato janë raste të cilat personat nuk i kanë dërguar në 2 zarfe, njëra në zarfin e fshehtësisë dhe tjetra në zarfin ku vendoset letërnjoftimi, dhe një video që keni bërë edhe ju si LVV-ës, ku qartësisht i keni treguar atë procedurë ato raste nuk refuzohen, ato janë ato raste që ti nuk e dinë fletëvotimi i cilit person është , unë e di që këto janë raste që anulohen nga Shërbimi Votues.

Sami Kurteshi: Mendojë që pata me e sqaruar por faleminderit për një pjesë të sqarimit, unë pikërisht edhe këtë po e them dhe ky është sistemi bizantin për një fajtor më i dënuar 10 të pa fajshëm, ne e kemi këtë sistemin bizantin d.m.th që është bartur diku nga shekulli 10 të erës sonë deri tani neper lufta të ndryshme ju ma vrani një, unë ti vrajë 100. Mirëpo parimi i drejtësisë thotë se nder 100 është një fajtorë dhe nuk mundet të gjendet fajtori atëherë janë të gjithë të pafajshëm ky është sistemi i drejtësisë që i mbyll syt dhe thotë me fal por nuk mundem më i dënuar 99 sepse një qenka fajtor, kjo është qasja që e ka drejtësia dhe në këtë rast nëse ne duam të marrim vendim për anulim, ne mund ta marrim më një arbitraritet statistikor me të vogël secilin nga ata zarfe njërin dhe ta hedhim poshtë a e ditur cilit subjekt dhe cilit person dhe 9-të të tjerë janë të vlefshëm sepse i kanë dërguar dokumentet por jo 10 të i hedhim poshtë sepse njeri nuk e paska dërguar një dokument. Përveç asaj këta me gjasë janë ata aplikues që kanë aplikuar njëherë dhe janë konfirmuar, nuk janë të pakonfirmuar këta se po të ishin që nuk kanë aplikuar apo nuk janë konfirmuar në rregull është, por e kanë bërë një gabim.

Valdete Daka: Ne jemi duke diskutuar piken pa e miratuar rendin e ditës, në qoftë se bënë që ne të e miratojmë rendin e ditës dhe në kuadër të aktiviteteve të SKQZ-ës të gjitha këto çështje do të diskutohen aty. Ne nuk po mundemi as të e votojmë rendin e ditës për çështje paraprake. Kush është për këtë rend dite? Kush është kundër? Vazhdojmë më rendin e ditës Aktivitetet e SKQZ-ës.

Burim Ahmetaj: Sekretariati pas ditës së zgjedhjeve e deri me sot ka qenë vazhdimisht duke procesuar materialin zgjedhor, fillimisht ka pranuar të gjithë materialin e ndjeshëm të cilin e ka trajtuar dhe pastaj ka filluar më proceset tjera sic është procesimi i formularëve të rezultateve dhe vlerësimi i pakove të supozuara të fletëvotimeve më postë. Në shumicën e rasteve këto dy kanë qenë aktivitete kryesore të sekretariatit, pjesa e parë sa i përket procesimit të formularëve të rezultateve dhe të gjitha procedurat tjera janë përfunduar si rezultat i kësaj kemi pasur vendvotime të cilat janë rinumëruar për shkak të problemeve e mospërputhjes, 12 vendvotime janë rinumëruar nga karantina, sa i përket procesimit të formularëve të rezultateve 494 vendvotime nuk kanë mundur të e kalojnë auditimin dhe si rezultat i kësaj më rekomandim të QNR-ës dhe më vendim të KQZ-ës janë rinumëruar 494 vendvotime të cilat nuk e kanë kaluar auditimin dhe pastaj nga kontrollimi i data bazës apo bazës e të dhënave janë vërejtur se edhe 58 vendvotime të cilat kanë pasur probleme apo mospërputhje ndërmjet votave të subjekteve dhe votat të kandidatëve si rezultat kanë qenë së kandidat e subjekteve nga ato 58 vendvotime nuk kanë pasur vota fare.

Pra, të gjitha këto më vendim të KQZ-ës janë rinumëruar dhe procesi i rinumërimit është i mbyllur dhe janë procesuar në bazën e të dhënave të gjitha formularët e rezultateve qoftë për subjekte, apo për kandidat në bazën e të dhënave vetëm dy vendvotime që nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta, është fjala për 2 vendvotime të cilat janë rinumëruar dhe pas procesit të rinumërimit më tutje nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta për shkaqe të tejkalimit të nivelit të tolerancës, niveli i tolerancës është +,-3 që nënkupton dallimin mes nënshkrimeve dhe fletëvotimeve që tolerohet deri në 3, mirëpo nuk mund të tolerohet apo të pranohet asnjë tolerancë tjetër më e madhe së sa 3, kemi dy raste edhe pse këto 2 vendvotime janë rinumëruar prapë se prapë kanë përfunduar në auditimi dhe nuk munden të e kalojnë auditimin është fjala për një vendvotim në komunën e Vushtrrisë 27/17B/01R ku edhe pas hetimit, pas procesit të verifikimit që është bërë në QNR rezulton së janë 5 fletëvotime më shumë se sa nënshkrime. Rastit tjetër është në komunën e Mitrovicës së Veriut pothuajse është i njëjti rast mirëpo kemi 10 fletëvotime më shumë se sa nënshkrime, pra këto dy vendvotime nuk munden të procesohen si të rregullta në mënyrën se si janë. Po ashtu QNR-ja ka bërë hetime pas procesit të rinumërimit dhe gjendja

është, si është edhe e përshkruar në raportin nga QNR-ja. Behet fjale për 2 vendvotime të cilat e kalojnë nivelin e tolerancës, njeri vendvotim ka 5 fletëvotime më shumë se sa nënshkrime dhe vendvotimi tjetër ka 10 fletëvotime më shumë se sa nënshkrime.

Të dy këto vendvotime, rekomandimi është që të mos përfshihen në rezultatet përfundimtare, përndryshe pa këto dy vendvotime të gjitha materialet e tjera nga formularët e rezultateve, nga vendvotimet e rregullta janë të procesuara në bazën e të dhënave, pra i bije që pa këto dy vendvotime. Procesi i numërimit të votave më kusht është përfunduar me datën 1 mars dhe tani jemi në procesin e procesimit e të dhënave nga formularët e rezultateve të dengut dhe formularët e rezultateve të kandidatëve në bazën e të dhënave për të i përfshirë në rezultatet përfundimtare dhe po ashtu sot ka filluar procesi i numërimit të votave më post, proces i cili mendojmë që do të mbyllet nesër në mënyrë që të i përfshimë në rezultatet përfundimtare do të i kemi rezultatet e rregullta, rezultatet e votave më kusht dhe rezultatet e votave më post të cilat jemi duke i pritur në mënyrë që të kompletohen të gjitha rezultatet dhe të sjellën para KQZ-ës si të tërësishme. Po ashtu sekretariati ka sjellë edhe dy raporte që ndërlidhen me Shërbimin Votues dhe ka të bëjë më periudhën e votimit përmes postes, SKQZ-ja ka pranuar pako të supozuar më fletëvotime pas përfundimit të periudhës së votimit përmes postes, periudhë e cila është mbyllur më 12 shkurt 2021. Tërheqja e këtyre pakove është bërë më qellim të ruajtjes e të dhënave personale që mund ndodhen brenda tyre, tërheqja është bërë në 3 ditë të ndryshme më datën 18 dhe 19 është bërë nga posta e shpejt DHL që janë 691 dhe 27 pako ndërsa më 25 shkurt nga Fahu Postar janë tërhequr 9030 pako pra gjithsej bëjnë 9748 pako, këto pako janë të vendosura në depo qendrore të KQZ-ës. Pra këto kanë ndodhur me datën 18,19 dhe 25 shkurt.

Ndërsa, sa i përket raportit të votimit përmes postes, raportin e keni në detaje për secilën dërgesë apo secilën kontingjent të pakove të fletëvotimeve të supozuara të cilat janë marr sipas datave deri më 12.02.2021 dhe në total janë 43.477 pako më fletëvotime të supozuara. Vlerësimi i pakove të supozuara ka filluar procesi i vlerësimit pasdites së zgjedhjeve dhe janë kriteret të cilat KQZ-ja i ka miratuar dhe nga ky proces i verifikimit dhe vlerësimit, faktikisht të pakove fletëvotimeve të supozuara rezulton se janë 56.610 fletëvotime të cilat do të numërohen si të rregullta në QNR proces i cili ka filluar sot. Ndërsa numri i pakove të refuzuara është 22.591 nuk janë pako mirëpo janë zarfe individuale. Këto janë shifrat nga Shërbimi votues dhe sigurisht që në raport i keni në detaje për secilën kategori nga D1 deri në D8, ndërsa D4,D3 ndërlidhet më zgjedhjet lokale. Po ashtu në raport i keni të ndara sipas shteteve numrin e pakove më fletëvotime të aprovuara sipas shteteve dhe në faqen 5 e keni numrin e pakove apo fletëvotimeve të aprovuara për se cilat komuna në Republikën e Kosovës dhe totali i fletëvotimeve të vlefshme të cilat numërohen nga votat më postë është 56.610, ky është raporti nga QNR-ja që përmbledh të gjithë

procesimin e materialeve zgjedhore dhe që përfshinë edhe votat përmes postes dhe tani konsiderojmë që të gjitha procedurat e rregullta janë përfunduar sa i përket procesimit të materialit të rregullt po ashtu materialit të votimit më kusht dhe tani jemi në procesin e numërimit të votave më post në mënyrë që të i bashkohen rezultateve të rregullta dhe të jenë të gatshme për KQZ. Ky është raporti mirëpo në mënyrë që të procesohet më tutje është fjala për 2 vendvotime të cilat i ceka më herët do të na duhet patjetër vendimmarrje e KQZ-ës në mënyrë që të procedohet me tutje sepse në gjendje çfare janë nuk mundën të procesohen të rregullta dhe kërkojmë miratimin nga KQZ-ja të rekomandimit.

Valdete Daka: Së pari, do të vendosim lidhur me rekomandimet e QNR-ës dhe ajo është lidhur më këto 2 vendvotime, të cilat ashtu si u sqaruan nuk ka mundësi të inkuadrohen në rezultatet përfundimtare për shkak të mos përputhjeve që ka në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve, pra i kemi 2 rekomandime. Atëherë, kush është për që të mos përfshihen në rezultatet përfundimtare fletëvotimet nga vendvotimi 2717B/01R nga komuna e Vushtrrisë sepse e njëjta ka mospërputhjen në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve, pra janë 5 fletëvotime më shumë se nënshkrime. Kush është për? Rekomandimi i 2-të është rezultatet nga vendvotimi 3805B/05R nga komuna e Mitrovicës së Veriut të mos përfshihen në rezultatet përfundimtare meqenëse ka mospërputhje në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve, pra janë 10 fletëvotime më shumë se nënshkrime. Kush është për? Këto janë rekomandimet që kanë ardhur nga QNR-ja, ndërsa për çështje tjera mund të diskutojmë.

Sami Kurteshi: Unë mendojë që kjo është një shenjë e punës së mirë dhe kjo duhet të respektohet dhe përveç rekomandimit që këto dy vendvotime të mos përfshihen, unë kërkojë tani procedur nuk e di si do të ndiqet por të dy këto vendvotime komisionarët të marrin dhe të dërgohen në prokurori, si është e mundur që të futen më shumë fletëvotime se sa nënshkrime, a janë 5,2 apo 3 unë mendojë që ne duhet më e ulur tolerancën në 0, por jo papërgjegjësitë e atyre personave që e kanë dërguar këtë në KQZ, kush do që të jenë, unë e di që komisionarët i caktojnë partitë politike por i paguan KQZ-ja, ata paguhen më para publike dhe unë mendojë që këto dy vendvotime, persona që e kanë udhëhequr këtë procedurë të i dorëzohen prokurorisë dhe prokuroria të merret më këtë rast.

Valdete Daka: Jo vetëm këta dy por edhe ata të tjerët kutit të cilat janë rinumëruar dhe ka pasur mos përputhje të mëdha matematikore sidomos të kandidatet sepse të partitë nuk kemi pasur, gjithmonë janë dërguar që nga viti 2010 po dërgohen në prokurori kompetente dhe pastaj ata përgjigjen për vepra penale të cilat i parasheh kodi penal i Republikës së Kosovës. Po ashtu edhe ata të cilët kanë votuar nga dy herë,

pra e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre dy herë, kanë votuar në vendvotimet e rregullta dhe në vendvotimet më kusht por edhe ata të cilët nga diaspora kanë votuar njëherë më post dhe njëherë me kusht në vendvotimë apo të rregullta dhe emrat e tyre do të dërgohen në prokurori menjëherë pas certifikimit të rezultateve ashtu siç kemi bërë gjithë.

Alim Rama: Kur jemi të votimet më kusht, në raportin në QNR i cili nuk u shpalos këtu në detaje ka dal që mbi 2000 përfaqësues prej të cilave 1000 e diçka kanë qenë persona që nuk kanë qenë në listën përfundimtare të votuesve dhe këtu është një kundërthënie mes ligjit për zgjedhje dhe rregullores së QNR-ës. Ligji për zgjedhje neni 95 thotë: votimi më kusht ku votuesi në Kosovë emri dhe mbiemri i të cilit nuk mund të gjendet në listën përfundimtare të votuesve ose që emri që emei i saj gjendet në listën përfundimtare të votuese por më një shënim tregon që ai duhet të votoj më kusht, në anën tjetër ne po thojmë që ai duhet të votojë më kusht ndërsa këto 1000 e sa kanë qenë janë larguar.

Unë mendojë se, para se të përfundoi ky proces këtu duhet të vazhdojë hetimi më tutje a është lëshim i ARC-ës, sepse ka mundësi të jetë lëshimi teknik sepse ata të gjithë personat kanë pasur një dokument personal të Kosovës më të cilat kanë dëshmuar që janë shtetas të Kosovës, ose është lëshimi i KQZ-ës në përpunimin e listave përfundimtare të votuesve por në të 2 këto rate, ai qytetari që ka dalur në vendvotim nuk ka të drejtë dhe vota e tij duhet të konsiderohet si e vlefshme sepse unë veç ju referova ligjit, unë e pash nenin e rregullores për QNR, thotë pak më ndryshe por ligji e dominon rregulloren në çfarëdo rasti ligji ka përparësi ndaj rregullores, kështu që rregullorja në këtë rast nuk mundet të merret si bazë sepse rregullorja të neni 6 ceket që votat me kusht janë vetëm për ata që nuk janë në listën përfundimtare të votuesve. Këtu kemi një kundërthënie që duhet patjetër të trajtohet sa i përket raportit që e kemi lexuar të votave më post, unë kërkova edhe me email para disa ditëve në mbledhje që të trajtohen këto refuzime vetëm për një ditë me herët kemi pasur për 578 votues janë kthyer prej të refuzuar në të rregullt. Ndërsa disa procedura kanë ndodhur pas përfundimit të certifikimit të listës përfundimtare të votuesve, deri sa lista përfundimtarë votuese si brenda si jashtë Kosovës është certifikuar më 02 shkurt dhe kjo automatikisht rrjedh se edhe për listën përfundimtare të votuesve brenda Kosovës. PZAP-ja i ka kthyer një numër një numër të caktuar të votuesve ju ka dhen të drejtën e votës që të votojnë më post, po ashtu edhe më korrigjimet e brendshme më një listë e cila ju shpërnda anëtareve të KQZ-ës, disa persona janë kthyer edhe më ato korrigjime të brendshme. Kjo na dëshmoj se lista e cila është certifikuar ka pasur lëshimet e veta, për shkak të këtyre lëshimeve disa prej këtyre ndoshta jo të gjithë por disa nga këto: personat që nuk kanë aplikuar në periudhën e aplikimit për regjistrim janë 9199 disa nga këta kanë aplikuar ose disa prej atyre që janë refuzuar ka mundësi që kane pasur të drejtë sepse ka pasur lëshime

në procesin e përpilimit të listës. Të dy këto kategori përafërsisht janë 15.500 votues, pra 15.500 votuesve që kanë dërguar zarfet për të votuar.

E kemi edhe një kategori tjetër, e diskutuam edhe në mbledhjen e kaluar se KQZ-ja më 14 shkurt ka marr vendimin të aprohohen dokumentet më afat të skaduar, të gjithë këta persona që janë 2451 që nuk janë të identifikuar ata njëherë janë identifikuar gjatë procesit të aplikimit do të thotë që këtu kemi një shkelje, kemi një vendim të KQZ-ës më 14 shkurt në orën 14:00 që ju lejon personave edhe me dokumente më afate të skaduar po ashtu të gjithë këta persona kanë pasur dokumente valide në momentin e aplikimit dhe këtu janë 2451 persona që kanë votuar. Po ashtu ajo kategoria që e përmendi edhe kolegu Kurteshi të shumë zarfeve brenda një pakos këtu kemi rastin e penalizimit total, kështu që nuk mundet të penalizohen 5 persona për shkak të njërit ose 10 sa do qofshin, të gjitha këto procedura as nuk janë publike si procedura se si veprohet në trajtimin e votave më post e as procedurat e QNR-ës, detale të cilat kanë interpretime të ndryshme, vetëm sot në mëngjes ka pasur tendencë me interpretuar numri i zarfeve brenda për brenda më numrin, me sikersat që kanë qenë në folje kjo është rregulluar, por problemi është që duhet të koordinohen për një procedura të aprovuar të mos varet në interpretimin të personave që janë të punësuar në një proces si të përkohshëm ata nuk kanë të drejtë ligjore më ja ndaluar asnjërit votën dhe interpretimet të ndryshme na sjellin këto, ka qenë një kërkesë më herët që të krijohet një komision i cili merret me këto raste nuk kemi nevojë që në QNR gjithë të krijohet zhurmë dhe kjo mënyrë të vazhdueshme gati gjatë gjithë procesit.

Sami Hamiti: Në fillim e thash që kemi vendosur disa rregulla për votim jashtë vendit dhe nuk është e vërtetë që nuk ekzistojnë, ekzistojnë në ueb-faqen e KQZ-ës dhe ato i kemi aprovuar bashkërisht unë dhe ti Alim dhe tekstin se kur mundet të votoj dhe kur mundet me i dërguar, pse mund të i dërgoj dhe kemi punuar bajagi gjatë që me ja lehtësuar votimin jashtë vendit. Nuk është e vërtetë që nuk ekzistojnë në KOZ i kemi votuar, i kemi qitur atë ditë tekstet për dy formularët se si do të jenë si do të jenë kur do ti kur do ti pranohet, kur nuk do të i pranohet, cilat do të jenë kriteret dhe unë besoj që deri në atë pjesë ne mund të flasim më sekretariatit vetëm për a i kanë përfillur ato rregulla apo nuk i kanë përfillur jo tash të hyjmë në dhe të thajmë që ka ekzistuar diku një votues tjetër në 10 zarfe apo 15 zarfe, kemi saktësuar në atë dokument që në zarfin e madhe mund të jenë familjaret që janë më një mbiemër dhe që kanë aplikuar më të njëjtën adresë, tani po futumi edhe po e vejmë ne dyshim të gjithë këtë proces se po thojmë që janë 12 ose 13 edhe njëri ka qëlluar, nuk mundemi të vendosim rregulla sot i kemi vendosur paraprakisht, para ditës së votimit dhe kanë ekzistuar edhe më herët të gjitha janë çështje të cilat kanë ekzistuar më herët dhe njësoj janë trajtuar ato fletëvotime. Tani po dalim qesharak edhe po themi kemi ardhur në një situatë

që do ta marrim tani D1 dhe D2 se ka ndodhur, nëse ka ndodhur nuk po predikoj 100% po shembulli më e zhvlerësuar të gjithë procesin është gabim. Ne po themi nëse e mbi vlerësojmë këtë rast rregulloren dhe ligjin, dhe e dimë që më ligj nuk e kemi hiq aplikimin me email është vetëm me rregullore atëherë nëse mbizotëron ligji atëherë të gjitha më email-e bien, ka ekzistuar një rregull një procedurë edhe po ju lus jemi në një situatë që jemi në shpallje të rezultateve, unë e di që ju keni fituar a jeni të gatshëm ju që ta merrni pushtetin apo çfarë jeni duke bërë. Të gjitha procedurat si i kemi vendosur këtu në KQZ.

Alim Rama: Rregulloret që janë aprovuar përpara kanë qenë në trajtimin e aplikacionit, unë këtë e konstatova vetëm në momentin që është certifikuar lista nuk është kontestuar rregullorja sepse proceduar është marr vetëm më trajtimin e email-ve, unë vetëm e konstatova që më 2 shkurt kur është përfunduar pavarësisht që e kemi cekur disa herë koha e ankesave, e kundërshtimit që ka qen nga 24 janar nuk është respektuar, tani më 2 shkurt në mbrëmje dikur rreth orës 20:00 u aprovuar lista përfundimtare e votuesve, ndërkohe ka pasur persona të cilve ju ka pranuar e drejta më votuar më post unë aty e kisha, ndërsa procedurat e atyre D1,D2 dhe ato D-ja ato procedura nuk janë publike, kjo ka të bëjë vetëm me trajtimin e zarfeve mbasandaj.

Valdete Daka: Sic e di unë procedurat janë në QNR i kanë të gjithë publikisht munden më i marr, ato procedura janë aprovuar qysh moti para shumë zgjedhjeve, pra procedurat e QNR-ës po ashtu e kemi dhe rregulloren në procedurat e QNR-ës së çfarë është zarf i pavlefshëm, pse dhe si e procedon QNR-ja më procedurat e numërimit ndërsa unë e pash një çështje e cila me intrigoj ajo është që vazhdimisht po përsëritet se më 02 shkurt është aprovuar lista votuese përfundimtarë e votuesve jashtë Kosovës dhe atyre brenda Kosovës dhe unë e pyes tani Burimin sepse unë e di që edhe pas vendimeve që i ka marr PZAP-ja, janë aprovuar ankesat edhe ata persona të cilëve ju ka aprovuar e drejta që të votojnë janë marr parasysh dhe të gjitha ato fletëvotime janë aprovuar nga QNR-ja. A janë marr të gjitha ato vendime nga PZAP-ja dhe a janë implementua? Sepse në fund të fundit sekretariati e bart përgjegjësin për të gjitha këto.

Burim Ahmetaj: Kërkoj mirëkuptimin e juaj por kishte me qenë mirë më i dhen disa përgjigje. Sekretariati i ka marr të gjitha vendimet që PZAP-ja i ka marr, mirëpo në pamundësi që të shtohen në listën përfundimtare të votuesve sepse ajo listë veç ka qenë në printim e sipër dhe e ka krijuar një listë e cila i ka publikuar së bashku, se ma lehtë ka qenë për ne që ta e publikojmë më listën e votuesve jashtë vendit dhe të gjithë ata emra i ka marr parasysh dhe i kanë krahasuar më votat me kusht, pra ka qenë një listë shtesë për ata që i kanë verifikuar, paraprkisht PZAP-ja ka marr vendim që vota e tyre të numërohet që

të i jepet e drejta për të votuar pra të gjithë janë të përfshirë. Janë edhe 2 çështje tjera të cilat i ngriti z.Rama dhe desha të dha përgjigje por a ka të beje më votuesit të cilët nuk mundën të gjenden në listën përfundimtare të votuesve që praktikash vota e tyre refuzohet, kjo ka të beje më të gjithë ata votues të cilët për një arsye apo një arsyeje tjetër nuk mund ta gjejnë fizikisht emrin e tyre në listën përfundimtare të votuesve dhe i jepet mundësia që në vendvotimin më të afërt për të votuar. Mirëpo KQZ-ja ka pasur periudhën e sfidimit të listës përfundimtare të votuesve dhe të gjitha ata votues të cilët nuk kanë mundur gjatë kësaj periudhe nuk kanë mundur ta gjejnë emrin e tyre në listën përfundimtare të votuesve kanë pasur mundësi të sfidojnë këtë listë dhe në mënyrë që të përfshihen, mirëpo është me rëndësi që të dimë që i gjithë opinionimi se lista përfundimtare e votuesve krijohet nga ekstrakti të cilin e merr nga regjistri civil i Kosovës dhe KQZ-ja as nuk e heq e as nuk e shton asnjërin nga votuesit pa pasur një vendim të tillë, pra kjo është procedura të cilën e bëjmë zakonisht në secilin proces zgjedhor.

Mirëpo' rregulla që e lexoi apo e potencoi z.Rama ka të bëjë më të gjithë ata që nuk mund ta gjejnë për arsye të ndryshme në ato momente veten në listë, në qendër apo ndonjë qendër tjetër dhe i jepet mundësia që të votojë, mirëpo nuk thotë që ata që nuk janë në listën përfundimtare të votuesve hiq të i jepet mundësia për të votuar më kusht. Ndërsa sa i përket votimit të personave më afat të skaduar të dokumentit, vendimin të cilin KQZ-ja e ka marr ditën e zgjedhjeve më 14 shkurt, unë sa e di ka pasur të bëjë vetëm më dokumente apo me votues të cilët kanë votuar në ditën e zgjedhjeve ky edhe ka qenë vendimi i KQZ-ës, pra ju ka lejuar të gjithë atyre personave për arsye të ndryshme nuk kanë pasur dokumente valide ju ka lejuar edhe me dokument të skaduar behet fjalë për të gjithë votuesit brenda vendit, kështu që nuk kemi ndonjë vendim, sekretariati nuk ka ndonjë vendim që ju referohet vendimit jashtë vendit mirëpo vetëm votimit brenda vendit. Kështu që sekretariati më shërbimet e veta ka në të gjitha periudhat, ka punuar duke respektuar secilën procedurë të miratuara nga KQZ-ja dhe sigurisht që kemi pasur shumë aktivitete, shumë procese mirëpo konsiderojmë se gjithçka e kemi bërë në bazë të procedurave.

Sami Kurteshi: Nuk po dua më e personalizuar as me bërë subjekt që a po duam që ta e marrim pushtetin a po jo se fundi fundit nuk vendosim ne, ka vendosur populli për atë. Çështja është diku tjetër dhe nuk ka të bëjë më këtë, z. Ahmetaj ju dëgjova me shumë kujdes edhe këtu e kemi diskutuar votuesit që kanë dërguar dokumente jo valide është marr vetëm për atë ditë dhe ky dokument i këtyre që janë jashtë vetëm për atë ditë do ju duhet, asnjëherë më nuk kemi me i pyet a keni dokumente valide apo jo valide vetëm këtë duhet që ta dini. Këta persona kanë aplikuar më dokumente valide janë konfirmuar në listën e juaj dhe tani përnjëherë nuk kanë dokumente valide kjo është ajo kundërthënia që ky popull më nuk po e

pranon në ditën e votimit, po thotë çfarë keni vepruar deri tani keni bërë katastrofë dhe tani ne po votojmë që të ndryshojmë këtë duheni që të e kuptoni njëherë. E dyta ju po thoni së të gjitha janë në rregull, për një javë rresht na i keni dhen këtë letër më kategoritë D1,D2,D4,D5,D6 për refuzimin e votave nga jashtë dhe përnjëherë në raportin e juaj vjen një letër ,më 8 kategori më të cilat keni vepruar ju, unë jam bazuar në këto tani më vjen 8 kategori, ndërsa këtu janë 5 çfarë rregulla paskemi ne bre, për cilat rregulla, ku i gjeni në rregulloret e KQZ-ës të brendshëm apo në ligje këto kategori, nuk i gjeni askund. A po e kuptoni se janë të marrura në mënyrë arbitrare si të kenë dëshirë, ku janë definicionet për këto kategori? Unë kam vepruar më 5 kategori dhe përnjëherë i kam 8 kategori. Z. Ahmetaj a i keni shpërndarë ndonjë herë këto 8 kategori, nëse thoni që keni ardhur rrallë në QNR dhe nuk kemi pasur mundësi që të ja jepmi nuk është e vërtet sepse unë përditë kam qenë në QNR për më se paku 5 orë dhe në 5 ore më është dhen kjo edhe përnjëherë më vjen një më 8 kategori, nuk mund të refuzohen njerëzit për dokumente jo valide, ditën e zgjedhjeve paskan ardhur në Kosovë sepse ata janë qytetar të Kosovës vlen për ata njësoj. Mirëpo ata kanë aplikuar më dokumente valide dhe përnjëherë del më dokumente jo valide, kurse sa i përket ati parimit bizantin nuk e di kush u prek ajo është parimi bizantin.

Unë, personalisht jam kundër hapur dënimit që thuhet këtu votuesit të pidentifikuar 10 votues, 10 vota më u anuluar sepse njeri nuk e paska dërguar një dokument identifikimi. Votuesit që kane dërguar fletëvotimet 2 herë të klasifikohen dhe të dërgohen në prokurori ose njëra të ju eliminohet, e dyta votuesi të pa identifikueshëm votimi grupor të hiqet vetëm njeri nga fletëvotimet dhe të mos dënohen 7 apo 8 të tjerë. Votuesit që kanë dërguar dokumente jo valide ata kanë aplikuar kanë dëshmuar që kanë dokumente valide dhe tani dalin me dokumente jo valide. Votuesit të cilët nuk kanë aplikuar në periudhën e aplikimit dhe dalin nga ky sekretariat me disa qindra që të vërtet kanë aplikuar dhe ju kanë hupur SKQZ-ja, ja ka humbur dokumentet dhe vërtetohet që kanë aplikuar dhe nuk janë futur votuesit e refuzuar në periudhën e aplikimit, votues që kanë aplikuar dhe janë gjetur dokumentet dhe janë vërtetuar që ata kanë aplikuar dhe janë refuzuar të padrejtë. Unë këtë po e kërkojë me e pa secila votë në veti është e vlefshme, ne e kemi marr arrogancën institucionale këtë s'po mundem më zgjedh këtu, anuloi votat nuk shkon kështu, qasja ndaj votës është arrogante institucionale, votuesi ka lindur për neve ky institucion është më i organizuar zgjedhjet më ja mundësuar sa më lehtë zgjedhjen njerëzve, me ja mundësuar zgjedhjen çdo person që e ka dokumentin e identifikimit të Republikës së Kosovës dhe i ka 18 vjet, nuk është i dënuar nga gjykata e ka të drejtën e votës më lehtësinë që ne po ja anulojmë votën, kjo nuk ka të bëjë më demokracinë kjo ka të bëjë më një shtet autokratik që thotë ty ta pranoj, ty nuk ta pranoj, ti banë, ti nuk banë.

Valdete Daka: Ky institucion vetëm sa për informatë z.Kurteshi i organizon zgjedhjet sipas një ligji dhe sipas rregulloreve të cilat i ka edhe i implementon ato, dokumentet valide edhe ai vendimi atë ditë ka qenë gabim dhe unë prapë e them dhe është gabim dhe ka me qenë gabim gjithmonë sepse për tu identifikuar duhet që ta kesh një dokument valid dhe ka qenë gabim dhe unë kam qenë kundër nga momenti i parë por ju keni vendosur më shumicë dhe ai vendim është marr dhe ai vendim ka më qenë gjithmonë ashtu, 100 herë le të ndërrohen pushtetet ai vendim ka me qenë ashtu sepse nuk ka lidhje ajo as me pushtete as me asgjë, ka lidhje më ligj dhe me rregulla çdo shtet demokratik funksionon sipas ligjeve edhe sipas rregullave pavarësisht së kush është në pushtet dhe kush nuk është në pushtet.

Sami Kurteshi: Një shtet që 1 vitë e gjysmë nuk jep letërnjoftime, nuk të jep dokument valid kjo do të thotë arroganca maksimale, institucionale që e ka dënuar populli më votën e vetë. Pse nuk jep sepse nuk ka letër.

Valdete Daka: Ka qytetar të cilët kanë edhe pasaporta dhe patentë të vozitjes nuk e kanë vetëm një dokument, dhe nëse të 3-te i kanë skaduar atëherë nuk kemi çfarë me ju bë.

Eshref Vishi: Unë kam qenë që ne fillim që mos të ulet niveli i takimeve të KQZ-ës, dhe të i dallojmë trajnimet nga takimet e KQZ-ës. Fatkeqësisht ne nuk e dimë a jeni në trajnim apo në takimet e rregullta të KQZ-ës, kemi pika vendimmarrës për administrimin e procesit zgjedhor, nuk ka rregulla specifike vetëm për këto zgjedhje prej së ekziston KQZ-ja këto rregulla kanë ekzistuar janë plotësuar dhe janë ndryshuar nder vite është vështir të kuptohet procesi zgjedhor për arsyeje se prej nga natyra është kompleks, si kundër nuk mund të kuptohet ligji i lexuar dhe rregullat e procesit zgjedhor kështu që duhet të kemi durim pak më tepër dhe një besim pak më të shtuar tek sekretariati në përvojën që ka dhe në profesionalizimin që ka në organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor. Këtë nuk e kanë për herë të parë, administrata nuk ka nevojë për menagjer dhe nuk ka nevojë për presion shtesë si ka ndodhur prej nga filli i procesit zgjedhor e sidomos prej hapjes së QNR-ës, për çdo ditë aty kemi pasur raste dhe ka raste që e dini se jeni prezent edhe ju ka pasur presione të vazhdueshme është një hierarki, një strukturë organizimi i punës që behet në QNR dhe ata prezenca jonë veç sa e ka renduar këtë situatë atje nuk ka pasur nevojë për këtë presion i cili tash po përfundon veç jemi në përmbyllje të këtij procesi zgjedhor. Mirëpo sekretariati duhet që të i besojmë dhe ai ka nevojë për kryerjen e punëve dhe aktiviteteve dhe kemi nevojë për bashkëpunim këtu më sekretariatit.

Alim Rama: Votuesit të cilët nuk kanë aplikuar ose votuesit të cilët janë refuzuar në kohën e aplikimit, kërkojnë që të behet edhe njëherë verifikimi i aplikacioneve të tyre neper emaile, që të mënjanohet çdo mundësi që një qytetar të vetëm ju mohua e drejta e votës për shkak të gabimeve teknike, ajo ka qenë kërkesa dhe shumë e thjesht edhe ajo duhet të zbatohet, KQZ-ja ka për obligim që ta zbatojë ligjin e zgjedhjeve dhe ligji i zgjedhjeve sa i përket votave më kusht.

Valdete Daka: Puna e QNR-ës ka qenë 100% mos të them 200% transparente, kanë qenë më qindra vëzhgues nga të gjitha subjektet politike, kanë qenë vëzhguesit e misionit evropianë, pra puna e QNR-ës është komplet transparente dhe këto rregulla dhe këto procedura nuk janë duke u zhvilluar për herë të parë këto zgjedhje sepse po krijohet përshtypja para të gjithëve që këto rregulla janë vendosur enkas për këto zgjedhje dhe jo nuk është e vërtet këtë duhet me e ditë të gjithë edhe opinioni publik dhe të gjithë ata që po na shikojnë apo që kanë më na pa sonte se këto rregulla kanë ekzistuar gjithmonë prej që ekziston edhe kur kanë fituar të gjitha subjektet politike të tjera pavarësisht se si kanë fituar dhe me sa kanë fituar, pra keto rregulla janë të njëjta për të gjithë dhe nuk i kemi shpikur sot e as nuk i kemi zbuluar sot por i kemi zbatuar gjithmonë në këtë mënyrë dhe asnjëherë nuk ka pasur probleme e as vërejtje e as në vitin 2019 ku po ashtu ka fituar VV-ja më të njëjtat rregulla sikur sot.

Sami Kurteshi: Në QNR merren vendime arbitrare nga njerëzit që nuk janë kompetent për çështje të votave.

Alim Rama: Unë kisha një kërkesë të gjitha D1-shat dhe D2-shat të i kemi atje dhe të kontrollohen edhe njëherë neper emaile është një kërkesë shumë e thjesht dhe e keni pasur më shkrim që një javë.

Burim Ahmetaj: Desha dy sqarime për D7 dhe D8, D1 deri në D6 vazhdimisht kanë qenë në imella dhe në raportimin paraprak në KQZ ndërsa D7 dhe D8 kanë ardhur si rezultat i të gjeturave që kemi pa gjithsecili nga ne që kemi qenë në QNR, për kategorinë D7 janë dërguar 153 pako më fletëvotime që tejkalojnë rrethin e ngushtë familjar kjo nuk është diçka që e kemi shpikur por është ajo qfarë na ka ardhur, rregulla e cila buron nga rregullat të cilat i ka përcaktuar KQZ-ja nuk është shpikje e sekretariatit është rregulla dhe respektimi i rregullës. Numri i pakove të individualizuara më fletëvotime të refuzuar sipas kësaj kategorie përmban gjithsej 1656 fletëvotime, si shembull e kemi brenda një pakos më fletëvotime kanë qenë 84 zarfe të individualizuar me fletëvotime jashtë rrethit të ngushtë familjar, ndërsa D8=shi ka të bëjë me paket e fletëvotimeve sipas kategorisë së refuzimit D8, pra nuk e përmban vulën dhe pullën postare të

postes dërguese nga shteti kush është, janë dërguar nga Kosova të gjitha këto janë si rezultat i atyre që na kanë ardhur kështu që D7 dhe D8 janë rezultat nuk e shpikje e sekretariatit por është rezultat i dërgesave që neve na kanë ardhur këtu, kemi edhe shërbimin votues ai mundet të na e tregojë edhe me shumë në detaje mirëpo për deri sa i kemi 84 zarfe me një pako dhe mbiemra shumë të ndryshëm këtë vetëm që KQZ-ja ka përcaktuar që vetëm ata që janë brenda rrethit të ngushtë familjar kanë të drejt të votojnë në atë mënyrë, kështu që ky është sqarimi nga ana e sekretariatit. Edhe verifikimet i kemi bërë, edhe në emaile i kemi bërë.

Burim Ahmetaj: Kategoria D8 që e keni para jush ka të beje më pako më fletëvotime sipas kategorisë së refuzimit D8 , nuk e përmban vulën dhe pullën postare të vendit dërgues e ka vulën e postes në Kosovë, që nuk është nga vendi që e ka vendbanimin dhe ku jepet mundësia e votuesit për të votuar jashtë vendit por e ka vulën edhe pullën postare të postes së Kosovës kjo është kategoria e D8.

Sami Kurteshi: Do të thotë që janë dërguar përmes postes së Kosovës, por nuk janë futur kështu personalisht, ajo me nuk është post e dërguar personalisht sepse ai e ka dërguar në postë, dërgesa e cila dorëzohet në postë nuk është personale por kalon neper një varg.

Burim Ahmetaj: Sigurisht i kemi votuesit të cilët i kemi të regjistruar dhe e dimë vendbanimin e tyre, supozojmë që banon në Gjermani, mirëpo kush na garanton neve që dikush tjetër më të dhënat të tije posten më numër 06 në Kosovë, kemi 380 raste të zarfeve me vula të Kosovës.

Sami Kurteshi: Unë pajtohem më këtë vetëm më një gjë nuk po pajtohem, dikush banon në Zelandën e Re dhe ka me udhëtuar për në Evropë...

Valdete Daka: A mund të vazhdojmë me mbledhje sepse këto mbledhje tonat janë shndërruar si kurrë parë nuk kanë qenë kështu edhe duke e falënderuar së pari Z. Sami Kurteshi... Vazhdojmë me aktivitetet e ZRPP-ës. Sekretariati është duke na dhen shënimet të cilat i kanë bërë, vlerësimet që i kanë bërë dhe nëse ka diçka përgjigjen të gjithë ata që kanë qenë aty, ju keni qenë atje i keni pa, i keni torturuar, për shkak të Z. Alim Rama një punëtor i QNR-ës ka dhen dorëheqje sepse nuk ka mundur që të e duroj më shumë atë çfarë i ka bërë 2 javë ditë apo 1 muaj. Ju jeni anëtar por nuk keni të drejtë me shkua edhe me ju përzier punëtorëve. Konsideroj që kjo mbledhje nuk mundet të mbahet deri kur z.Sami Kurteshi fillon që të sillet si njeri i kultuar vazhdojmë më mbledhjen...

Pjesa e dytë e mbledhjes...

Valdete Daka: Vazhdojmë mbledhjen e 23-të, pra vazhdimi i mbledhjes së 23-të më pikat të cilat kanë mbetur dhe ato janë aktivitetet e ZRPP-ës, raporti i këshillave të KQZ-ës, raporti për çështje ligjore.

3.Aktivitetet e ZRPP-së

Raportim për afatin e dorëzimit të Raporteve Vjetore Financiare për 2020

Yll Buleshkaj: E kam dërguar edhe një raport më email në emër të zyrës një raport në lidhje më afatin e dorëzimit të raporteve vjetore financiare të partive politike, ndoshta kësaj radhe gjendja është më keq se herët e kaluara sepse kemi 7 parti politike të cilat nuk kanë dorëzuar fare raporte financiare, në për të gjitha këto, për Partin e Drejtësisë, për Partin Social Demokratet, kemi marr në rekomandim për masa të sanksionimit siç e sheh ligji edhe ajo është 1000 euro dënim, ndërsa për çdo ditë që nuk e sjellin raportin shtohet për 0.01% dhe pse paraprakisht ashtu siç e dini e kemi organizuar edhe trajnimin për zyrtar financiar të partive politike dhe desha të ju informoj se edhe aty nuk ka qenë pjesëmarrja shumë. Nga 46 parti që i kemi ftuar vetëm 14 kanë dërguar përfaqesit të tyre financiar, ajo e cila do të ndryshoj nga herët e kaluarur ne nuk do e presim auditimin por do i shikojmë ashtu siç e parasheh ligji këto raporte a i përbejnë kërkesat minime ligjore, në qoftë së janë të kërkuar faturat janë faturat, subjektet politike i kanë të deklaruar në azhurnimet vjetore që i kanë 29 apo 30 zyre dhe i kanë të deklaruar te gjitha ato zyre apo janë të deklaruar që i kanë farë lloj kontributi dhe të gjitha partitë politike do i marrin këto komente pa e pritur auditimin sepse kemi vrenjtur që ka subjekte politike të cilat nuk e kanë deklaruar, ka subjekte politike pastaj shohim për raportet financiare të fushatës e zgjedhjeve të kaluara që nuk kanë raportuar aq shpenzime për raport e as për naftë, të gjitha këto sipas kompetencave që ka zyra do të i dërgojmë në komente paraprake pastaj do të i rekomandojmë për vendimmarrje edhe të KQZ-ja.

Sami Hamiti: Është e vërtet kjo që po e thotë dhe duhet të vendoset një rend në ato raporte, paraprakisht a i kanë kontribut apo nuk i kanë, po edhe në atë format le të i dorëzojnë. Sa më përket mua është krejt në rregull edhe sanksionimi i subjekteve që nuk i kanë dërguar raportet edhe pa e pritur auditimin më i dërguar dhe më i kërkuar komentet, unë e përkrahi plotësisht.

Yll Buleshkaj: Raporti që e kemi paraqitur është më shumë njoftues ndërsa do të vije në rekomandim për secilin rast specifik, po është e vërtetë z. Cacaj e ka dërguar ditën që ka qenë afati i fundit për dërgim të raportit një shkresë por për neve paraprakisht si zyre nuk është që ka ndonjë bazë ligjore kjo, nuk është dashur askush që të e pres ditën e fundit për të dërguar një shkresë apo për të e hartuar raportin. Të gjitha këto parti politike që janë këtu nuk janë parti të reja dhe e dinë se çka është kërkesë ligjore. Çfarë është më e keqja apo a me mira në këtë rast që ligji nuk parasheh mundësi për zgjatje të afatit dhe anën tjetër nuk e dimë se as qeveria a e ka zgjatur afatin për raportim financiar për biznese për shkak të kovidit , kështu që nuk kemi diçka relevante që mundem më lidh me dike tjetër kështu që më gjasë nuk do të pranohet kjo do të bëjmë dhe një analizë por nuk ka ndonjë bazë, besojë që një parti më një traditë të gjatë të bazohet vetëm në një zyrtar i cili ka probleme shëndetësore dhe të pret ai ditën e fundit për raportim.

Valdete Daka: Rekomandimi i zyrës është që Partia e Drejtësisë, Partia Social Demokrate, Partia Shqiptare Demokristiane,..., Alternativa Demokratike e Kosovës,... dhe Partia Demokratike e Unitetit, të gjobiten më gjobë më 1000 euro dhe më gjobë ditore prej 0.01% të shumës së gjobës bazë deri në paraqitjen e raportit, pra ky është rekomandimi. Kush është për?

Sami Hamiti: Vetëm më treguar që kemi atje llogari të argetushme kur dalim të raporti financiare na dali shumat të cilat kanë mbetur në obligim, por me gjithë atë paraqiten si llogari të argtushme që në një moment mund të merren dhe unë ë përkrahi rekomandimin.

Valdete Daka: Kush është për këtë rekomandim? Miratohet. Vazhdojmë më raportin e këshillave të KQZ-ës.

4.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në: Deçan, Shtime dhe Novobërdë:

Eshref Vishi: Këshilli për çështje ligjorë ka shqyrtuar kërkesat për zëvendësime për anëtarët e këshillave komunale të tri komunave Deçan, Shtim dhe Novobërdë kërkesat në fjale kanë plotësuar kriteret ligjore

për zëvendësim dhe këshilli rekomandon KQZ për miratimin e këtyre zëvendësimeve. Zëvendësimet, i keni më vendime përpara vetes.

Valdete Daka: Kush është që Ismet Çekja të emërohet anëtar i kuvendit komunal në Deçan nga subjekti politik LDK duke zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal Uran Tolaj? Kush është për? Miratohet...

Kush është për që Arbenita Halimi të emërohet anëtare e kuvendit komunal në Shtime nga subjekti politik PDK duke zëvendësuar anëtaren e kuvendit komunal Arbëresha Syla? Kush është për? Miratohet...

Dhe, kush është për që Lirim Gashi të emërohet anëtar i kuvendit komunal në Novobërdë nga subjekti politik LVV duke zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal Abdyl Gashi? Kush është për? Miratohet...

Pra këto ishin pika e mbetura nga mbledhja e kaluar, tanimë e dini së Këshilli për Çështje Ligjore pra do të këtë mundësi që të e mbaj takimin.

5.Të ndryshme !